

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, si gjykatë civile e shkallës së parë, gjyqtari Venhar Salihu, në çështjen juridike të paditësit nga Gjilani, Rr. " ", p.n, kundër të paditurit nga Gjilani, Rr. " ", nr. , të cilin me autorizim e përfaqëson jurist nga Gjilani <sup>1</sup>, me objekt kontesti vërtetimin e të drejtës së shfrytëzimit dhe posedimit pronësisë, jashtë senacës gjygjësore, më dt. 19.12.2017, mori këtë:

### AKTGJYKIM

-në bazë të pohimit-

- I. APROVOHET si e bazuar padia dhe kërkesëpadija e paditësit nga Gjilani e paraqitur kundër të paditurit nga Gjilani dhe VËRTETOHET se paditësi është shfrytëzues dhe posedues i ngastrës kadastrale numër të njësisë P- , në sipërfaqe prej m2, ngastër kjo e cila gjindet në Zonën Kadastzrale në Gjilan, e cila udhëhiqet në emër të të paditurit nga Gjilani.
- II. OBLIGOHET i padituri nga Gjilani që këtë të drejtë t'ia njej paditësit, dhe të duroj që paditësi nga Gjilani në Drejtorin për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Banim të regjistrohet si shfrytëzues dhe posesues në bazë të këtij aktgjykimi, në afat prej 15 ditësh nga dita plotëfuqishmerisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të dhunshëm.
- III. Secila palë bartë shpenzimet e veta procedurale.

### A r s y e t i m i

Paditësi më datë 02.10.2017, në këtë gjykatë ka paraqitur padi kundër të paditurit, me objekt kontesti vërtetimin e të drejtës së shfrytëzimit dhe posedimit pronësisë, duke theksuar se i padituri me dt. 8 Shkurt të vitit 2006 nga AKM-ja, ka blerë ndërmarjen " " me ngastrën nr. Gjilan dhe në bazë të marrëveshjes me të paditurin, paditësi kishte investuar në blerjen e sipërfaqes prej m2 të ngastrës nr. dhe nga kjo ngastër është krijuar ngastra kadastrale nr. në sipërfaqe prej €, por për shkak të arsyrave të ndryshme kjo sipërfaqe nuk ka mundur të bartet në emër të paditësit edhe për kundër faktit se i njëjti kishte investuar në shumë prej €, pëe sipërfaen prej m2.

Fillimisht paditësi ka kërkuar që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadija dhe të vërtetohet se i njëjti është shfrytëzues dhe posedues i paluejtshmërisë me numër të njësisë P- , në sipërfaqe prej m2 ZK Gjilan, e cila udhëhiqet në emër të të paditurit nga Gjilani dhe gjithashtu ka kërkuar që të vërtetohet se paditësi përveç të drejtës së shfrytëzimit dhe posedimit, me rastin e tjetërsimit të banesave që shfrytëzon në këtë njësi, i padituri duhet te paguaj shumën prej 16,66 %, nga sipërfaqja e banueshme.

### Juridiksioni dhe kompetenca e gjykatës

Gjykata në mbështetje të neneve 17 dhe 18 të LPK-së, fillimisht shqyrtoi juridiksionin e kësaj çështje juridiko civile dhe bazuar në nenin 41.1 të LPK-sw, konstatoi se çështja bën pjesë

<sup>1</sup> Nëpërmjet parashtrës së dt.19.10.2017, i njëjti ka dorëzuar autorizimin (të vërtetuar tek Noteri) dhe ka nftotuar se të paditurin e përfaqëson i njëjti.



në juridiksionin gjyqësor dhe kjo gjykatë është kompetente për të vendosur lidhur me këtë kontest, me arsyetimin se paluajtshmëria, objekt kontesti në këtë çështje është në Gjilan dhe kjo gjykatë është kompetente për ta gjykuar.

### Rrjedha e procedurës

Me dt.16.11.2017, gjykata nga paditësi ka pranuar një parshtrësë me të cilën ka bërë precizimin e padisë në kuptimin objektiv, me të cilën ka kërkuar që të petitumi i kërkesë padisë të jetë aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit nga Gjilani, dhe vërtetohet se paditësi është shfrytëzues dhe posedues i paluejtshmërisë me numër të njësisë P- , në sipërfaqe prej m2 ngastër kjo në ZK Gjilan, e cila udhëhiqet në emër të të paditurit nga Gjilani. Obligohet i padituri që këtë të drejtë t'ia njeh paditësit, ndërsa Drejtorati për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë detyrohet të bëj regjistrimin në emër të paditësit si shfrytëzues dhe posesues në bazë të këtij aktgjykimi, në afat prej 15 ditësh nga dita plotëfuqishmerisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

Pas pranimit të padisë, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 dhe 395 të LPK-së, të paditurit i ka dërguar aktvendim për përgjigje në padi, padinë së bashku me provat, në mënyrë që i njëjti të paraqesë përgjigje lidhur me pretendimet e paditësit.

Gjykata më dt.29.11.2017, ka pranuar përgjigjen në padi nga i padituri, përkatësisht nga ana e të autorizuarit të tij, ku nga përmbajtja e kësaj përgjegjje gjykata ka vërtetuar se i padituri ka pranuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar duke theksuar se paditësi është shfrytëzues dhe posedues i paluajtshmërisë-ngastrës kadastrale nr. , në sipërfaqe prej m2 ngastër kjo në ZK Gjilan.

### Gjendja faktike e vërtetuar

Gjyqtari i çështjes pas analizimit të pretendimeve të paditësit të paraqitura në padi, përkatësisht të pretendimeve të paraqitura nëpërmejt parashtrësës së dt.16.11.2017 dhe provave të bashkangjitura padisë dhe vlerësimit të përgjegjjes në padi nga ana e të paditurit, erdhi në përfundim se palët ndërgjyqëse disponojnë me këto të drejta dhe në rastin konkret nuk kemi të bëjme me kërkesa që palët nuk mundë të disponojnë lirisht përkatësisht në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me kërkesa që cenojnë rendin juridik, dispozita ligjore dhe rregulla të moralit shoqror. Në këtë konstatim gjykata erdhi duke u bazuar Çertifikatën e Pronës nr , dt.28.09.2017 ku është vërtetuar se posedues dhe shfrytëzues i ngastrës kadastrale nr. , në sipërfaqe prej m2 ZK Gjilan në Drejtorin e Kadastrit në Gjilan është regjistruar i padituri kurse nga Plotsimi mbi shitjen dt.08 Shkurt 2006 dhe Urdhër Transferi 03.10.2005 (lëshuar nga , gjykata vërtetoi se i padituri në emër të privatizimit- blerjes të -Gjilan, ka paguar çmimin në tërësi.

### Dispozitat ligjore të zbatuara


Gjykata duke vërtetuar gjendjen faktike të përshkruar si më lartë dhe duke gjetur mbështetje në nenin 148 të LPK-së, përkatësisht në pikën 1 të kësaj dispozite ku ligjvënësi ka paraparë " Në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykimi në bazë të pohimit)". Andaj, në rastin konkret i padituri ka pohura kërkesëpadinë e paditësit në njërin anë, kurse anën tjetër

gjqqtari i çështjes i bindur se në rastin konkret palët disponojnë lirisht me kërkesat juridiko-civile që i kanë parashrtuar në këtë procedurë, të njëjtën kohë disponimet nuk janë në kundërshtim me rendin juridik, dispozitat ligjore dhe rregullat e moralit publik (siç është paraparë në nenin 3 të LPK-ës), vendosi si në pikën I dhe II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 450 të LPK-ës që secila pale vet ti bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedural të veta, pasi që në rastin konkret ansnjëra pale nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedures.

Nga arsyet dhe dispozitat ligjore e theksuara më lartë, e bazuar në nenin 2, lidhur me nenent 142.1 dhe 143 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), gjykata vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN  
C.nr.717/17, dt.19.12.2017

Gjyqtari  
Venhar SALIHU  


**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh pas ditës të pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë përmes kësaj gjykate.